REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 593 Regj Lushnje, më 06.10.2021

VENDIM –SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Në Lushnje, sot më datë 06.10.2021,
Unë Brikena Luto, me detyrë Përmbarues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje, pasi studiova aktet proçeduriale të çështjes përmbarimore nr.593, datë 13.09.2021 bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr.370, datë 10.09.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje,

K O N S T A T O V A :

Se në datë 22.09.2021 është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje kërkesa e kreditorit Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje së bashku me " Urdhërin e Ekzekutimit " nr.370, datë 10.09.2021 të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për vendimin me nr.154, datë 12.07.2020 të Gjykatës së Shkallës së Shkallës së Parë Lushnje me palë:

- Kreditor : Buxheti i Shtetit
- Debitor : Damjano Ardian Saraçi
- Objekti : Shpenzime proçeduriale

Nga ana e Zyrës së Përmbarimit Lushnje ka filluar proçedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbrimor Gjyqësor"*, i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar.Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Damjano Ardian Saraçi nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kredirore Buxhtetit të Shtetit për shpenzime proceduriale në vlerën 1 658 lekë.
Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr.8730, daë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbrimor Gjyqësor"*, i ndryshuar.

V E N D O S A :

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 07.10.2021 – 26.10.2021 të debitorit Damjano Ardian Saraçi;
2. Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, Bashkia Lushnje, një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Damiano Ardian Saraçi me banim në rrugën "Reshat Shazivari" , Nd. 44, H. 1, Lushnje
4. Pala debitore Damiano Ardian Saraçi me banim në rrugën "Reshat Shazivari" , Nd. 44, H. 1, Lushnje të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje në lagjen " Çlirim" , kati i parë, hyrja mbarapa në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontatkte me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t'iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 06.10.2021.

PËRMBARUES GJYQËSOR
Brikena Luto